2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <p>a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;</p> |

- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
 3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
 4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr.	Emertimi	Specifikime Teknike
1	Libri i daljes se perkohshme e armatimit	Libri i daljes së përkohshme e armatimit: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
2	Libri i kontrollit te automjeteve në objekt	Libri i kontrollit të automjeteve në objekt: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
3	Libri i kontrollit dhe lejimit për shërbim	Libri i kontrollit dhe lejimit për shërbim: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
4	Libri i lënies së adresave	Libri i lënies së adresave: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
5	Libri i levizjes së automjeteve	Libri i levizjes së automjeteve : Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
6	Libri i planizimit të shërbimit	Libri i planizimit të shërbimit: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar

7	Libri i proces-verbaleve	Libri i proces-verbaleve: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
8	Libri i lënies së detyrave	Libri i lënies së detyrave: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
9	Libri i marrje-dorëzim shërbimi nga roja	Libri i marrje-dorëzim shërbimi nga roja: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
10	Libri shërbimi i oficerit të rojes	Libri shërbimi i oficerit të rojes: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
11	Libri i shërbimit të rojes në objekt	Libri i shërbimit të rojes në objekt: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
12	Evidencë shërbimi	Evidencë shërbimi: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 50 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat 15x21, ne formë fletoreje, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
13	Libër i instrukazhit të personelit të shërbimit	Libër i instrukazhit të personelit të shërbimit: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar

14	Libër i kontrollit të objekteve	Libër i kontrollit të objekteve: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
15	Libër i kontrollit të punimeve në objekt	Libër i kontrollit të punimeve në objekt: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
16	Libër i kontrollit të korespodenës zyrtare	Libër i kontrollit të korespodenës zyrtare: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
17	Libër i kontrollit të pakove, sendeve , objekteve, dhuratave Etj	Libër i kontrollit të pakove, sendeve , objekteve, dhuratave Etj: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
18	Libër i kontrollit të eskortave	Libër i kontrollit të eskortave: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
19	Libër i dinamikës së veprimtarisë	Libër i dinamikës së veprimtarisë: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
20	Libër i kontrollit të lejimit për qitje	Libër i kontrollit të lejimit për qitje: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar

21	Libri i shërbimit përgjegjës ruajtje objekti	Libri i shërbimit përgjegjës ruajtje objekti: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
22	Libër shërbimi me tre turne	Libër shërbimi me tre turne: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
23	Libër shërbimi me dy turne	Libër shërbimi me dy turne: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
24	Libër shërbimi me një turn	Libër shërbimi me një turn: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
25	Libër shërbimi asistuesi	Libër shërbimi asistuesi: Të jenë me leter 80 gr offset me qepje dhe ngjitje , 100 fletë , kapaku të jetë me karton 2100 gr , përmasat format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modelit të përcaktuar
26	Bllloqe fletë udhëtimi pa GPS	Bllloku duhet të përmbajë 100 fletë , përmasa format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët e fletës sipas modelit të përcaktuar (bashkëlidhur specifikimeve)
27	Bllloqe fletë udhëtimi me GPS	Bllloku duhet të përmbajë 100 fletë , përmasa format A4, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga një anë e fletës sipas modelit të përcaktuar (bashkëlidhur specifikimeve)

28	Dosje mjetesh plastike	Dosja duhet të jetë i gjithi material plastik me këto përmasa: gjatësia 37 cm, dhe gjerësia 27 cm, e cila duhet të mbyllet me kapak e pajisur me perçinë
29	Libreza mjetesh	Libreza duhet të përmbajë 5 fletë, ku vetëm faqja e parë duhet të jetë karton jo lehtësisht i përkthyesëm
30	Kartela personale veshmbathje	Fleta e kërtelës duhet të jetë karton 250 gr, ngjyrë e bardhë pa llustër (mat) , format A4

Modelet për artikujt janë bashkëlidhur DST-së.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve objekt prokurimi Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Nr	Emertimi i artikujve	Përshkrimi	Sasia e pritshme	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Libri i daljes së përkohshme e armatimit	Sipas specifikimeve teknike	150	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
2	Libri i kontrollit të automjeteve në objekt	Sipas specifikimeve teknike	90	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
3	Libri i kontrollit dhe lejimit për shërbim	Sipas specifikimeve teknike	150	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
4	Libri i lënies së adresave	Sipas specifikimeve teknike	90	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
5	Libri i lëvizjes së automjeteve	Sipas specifikimeve teknike	105	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
6	Libri i planizimit të shërbimit	Sipas specifikimeve teknike	1.500	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
7	Libri i proces-verbaleve	Sipas specifikimeve teknike	30	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I

					lidhjes se çdo minikontrate
8	Libri i lenies se detyrave	Sipas specifikimeve teknike	1.200	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
9	Libri i marrje - dorëzim shërbimi nga roja	Sipas specifikimeve teknike	1500	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
10	Libri Shërbimi i oficerit të rojes	Sipas specifikimeve teknike	900	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
11	Libri i shërbimit të rojes në objekt,	Sipas specifikimeve teknike	60	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
12	Evidence shërbimi	Sipas specifikimeve teknike	525	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
13	Libër i instruktazhit të personelit të shërbimit	Sipas specifikimeve teknike	150	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
14	Libër i kontrollit të objekteve	Sipas specifikimeve teknike	185	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
15	Libër i kontrollit të punimeve në objekt,	Sipas specifikimeve teknike	180	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate

16	Libër i kontrollit të korespondencës zyrtare	Sipas specifikimeve teknike	180	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
17	Libër i kontrollit të pakove, sendeve, objekteve, dhuratave etj,	Sipas specifikimeve teknike	180	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
18	Libër i kontrollit të eskortave	Sipas specifikimeve teknike	120	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
19	Libri i Dinamikes së Veprimtarisë	Sipas specifikimeve teknike	120	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
20	Libri i kontrollit të lejimit për qitje	Sipas specifikimeve teknike	480	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
21	Libri i shërbimit përgjegjës ruajtje objekti	Sipas specifikimeve teknike	525	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
22	Libër shërbimi me tre turne	Sipas specifikimeve teknike	510	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
23	Libër shërbimi me dy turne	Sipas specifikimeve teknike	120	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
24	Libër shërbimi me nje turn	Sipas specifikimeve teknike	60	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I

					lidhjes se çdo minikontrate
25	Libër shërbimi Asistuesi	Sipas specifikimeve teknike	60	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
26	Bloqe fletë udhëtimi pa GPS	Sipas specifikimeve teknike	72	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
27	Bloqe fletë udhëtimi me GPS	Sipas specifikimeve teknike	9	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
28	Dosje mjetesh plastike	Sipas specifikimeve teknike	497	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
29	Libreza mjetesh	Sipas specifikimeve teknike	150	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate
30	Kartela personale veshmbathje	Sipas specifikimeve teknike	750	Garda e Republikës	Brenda 20 ditëve nga momenti I lidhjes se çdo minikontrate

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrime për Gardën e Republikës”

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike dhe materialeve bashkëlidhur DST-së

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Garda e Republikës

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10**;

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- | | |
|--|--------------|
| • Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; | 1 (një) copë |
| • Makinë qepëse | 1 (një) copë |
| • Makinë telefoni; | 1 (një) cope |

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- c) 1 (një) punonjës ndihmës,
- d) 1 (një) shofer.

Për punonjësit në pikat a dhe c duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësin në pikën b duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;
- kontratë pune, të vlefshme

Për shoferin duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme,
- Leje drejtimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti, për transportin e materialeve të shtypura, objekt prokurimi. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion për mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimit të mjetit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se mundësojnë transportimin e materialeve të shtypura, objekt prokurimi, me shpenzimet e veta, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja nënkontraktimit e	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
